

# Programi Përgatitor për Specialist të Avancuar të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Bliterm, e licencuar nga **Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve**, ofron programin profesional për **Specialist të Avancuar të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP)** – një trajnim i specializuar, i dedikuar për profesionistët që synojnë të avancojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në industri me risk të lartë.

Ky program përbën nivelin e dytë të specializimit pas përfundimit të trajnimit **Specialist Themelor të SSHP**, dhe është krijuar për të ofruar njohuri të thelluara praktike dhe teknike për situata të industrive specifike me rrezikshmëri të lartë.

Programi është i ndarë në **pesë veprimtari profesionale**,

- Ndërtim
- Prodhim
- Transport
- Miniera
- Pylltari / Bujqësi

## Qëllimi i Programit

Programi synon të:

- Përgatisë specialistë që zotërojnë njohuri të avancuara mbi rreziqet specifike të industrive me risk të lartë;
- Pajisë pjesëmarrësit me aftësi praktike për identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e faktorëve specifikë të riskut;
- Sigurojë kompetenca të thelluara për reagimin ndaj aksidenteve, emergjencave dhe situatave kritike në sektorë me rrezikshmëri të shtuar;
- Mundësojë zhvillim profesional për role të specializuara në kompani ku kërkohet ekspertizë më e thelluar e SSHP-së;
- Përgatisë kandidatë që mund të ofrojnë asistencë profesionale në kompani të industrive të larta të rrezikut me deri në 50 të punësuar.

Pas certifikimit, kandidati mund të punojë si **Specialist i Avancuar i SSHP** në kompani me **deri në 50 punëtorë**, në kompani me risk të lartë të veprimtarisë së njejtë sikurse dhe kualifikimi I marrë.

## Kushtet e Pranimit

Për t'u regjistruar në program, kandidati duhet të ketë:

- Arsim **të mesëm** ose **universitar**, dhe
- **Të ketë përfunduar me sukses trajnimin Specialist Themelor të SSHP**, si kusht për njohuritë bazike të nevojshme.

## Modulet e Programit

Programi përfshin këto module përgatitore, të fokusuar në industrinë specifike të zgjedhur nga kandidati:

- **Situata e përgjithshme në industrinë me risk të lartë**

Tendencat, sfidat dhe karakteristikat e industrive të rrezikshme.

- **Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale**

Analiza e rasteve të shpeshta në industri me risk të lartë dhe faktorët kontribuues.

- **Faktorët specifikë të riskut në vendin e punës**

Identifikimi dhe vlerësimi i faktorëve tipikë të riskut për veprimtarinë përkatëse.

- **Masat parandaluese specifike për industrinë**

Teknika dhe standarde për reduktimin e riskut në sektorët e ndërtimit, prodhimit, minierave, transportit apo pylltarisë/bujqësisë.

- **Ndihma e parë dhe planifikimi i emergjencave**

Reagimi profesional në situata emergjente dhe organizimi i masave të sigurisë.

- **Puna praktike**

Ushtrime në terren, analiza e rrezikut, demonstrime dhe situata reale nga industria.

## Metodologjia e Trajnimit

Trajnimi zhvillohet përmes:

- Ligjëratave të avancuara
- Demonstrimeve dhe ushtrimeve praktike të specializuara
- Studimeve të rasteve të industrisë
- Përgatitjes specifike për testimin përfundimtar

Pas përfundimit të trajnimit, mbahet **testi përfundimtar**, pas të cilit lëshohet **Certifikata e Specialistit të Avancuar të SSHP-së**.

## **Kohëzgjatja dhe Organizimi**

- **Fondi i orëve:** 20 orë (10 orë teori + 10 orë praktikë)
- **Lokacioni:** Prishtinë

**APLIKO TANI:** \_\_\_\_\_